



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË  
FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT  
TË UJËRAVE TË NDOTURA  
KOMISIONI KOMBËTAR RREGULATOR**

**VENDIM**

**Nr. 41, datë 01.06.2018**

**PËR LICENCIMIN E UJËSJELLËS KANALIZIME SH. A FINIQ**

Në zbatim të nenit 14, pika 1/a, nenit 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", VKM nr. 958, datë 06.05.2009 "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence", si dhe Rregullores së licencimit miratuar me vendim të KKRR nr. 29 datë 08.12.2009 "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", e ndryshuar dhe pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria Teknike Ekonomike, mbi aplikimin e shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime sh.a Finiq për licencim për herë të parë, Komisioni Kombëtar Rregullator,

**Konstatohet se:**

- Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime sh.a Finiq ka aplikuar pranë ERRU për licencim për herë të parë me shkresën me nr. prot. 245 të datës 23.04.2018 për ofrimin e shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura.
- Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime sh.a Finiq është themeluar më datë 26.07.2017, si një shoqëri aksionere me një nivel administrimi në pronësi të Bashkisë Finiq, në përputhje me parashikimet e VKM nr. 63, datë 27.1.2016 "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura". Kjo shoqëri është regjistruar në QKB në datën 31.07.2017 me NUIS L76931502F.

- Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime sh.a Finiq i shërben pjesërisht Bashkisë Finiq, pasi 9 (nëntë) fshatra furnizohen me ujë nga Ujësjetllës Kanalizime Sarandë sh.a., ku Bashkia Finiq zotëron 37.5 % të kësaj shoqërie.
- Asambleja e përgjithshme e UK Sarandë me vendimin nr. 1, datë 24.04.2017 ka vendosur fillimin e procedurave për zvogëlimin e kapitalit të shoqërisë, me vlerën e aktiveve materiale (grupi i objekteve) që i transferohen Bashkisë Finiq.
- Në dosjen e aplikimit mungonte dokumenti Akt miratimi higjieno - sanitar, ndërkohë që ishte sjellë vetëm raport analiza e burimeve nga Drejtoria e Shëndetit Publik. Dosja u plotësua me datë 05.05.2018.
- Aplikimi i shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Finiq sh.a. plotëson kërkesat e parashikuara në Rregulloren e Licencimit për licencim për herë të parë, konkretisht:
  - Formati i aplikimit është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;
  - Për dokumentin Ekstrakt Historik i Regjistrimit Tregtar në të cilin ende nuk janë reflektuar ndryshimet sipas riorganizimit të shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime sh.a Finiq bazuar në VKM nr. 63, datë 27.01.2016, "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura", shoqëria Ujësjetllës Kanalizime sh.a Finiq detyrohet të paraqesë pranë ERRU ekstraktin e QKB të përditësuar menjëherë pas përfundimit të procesit.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator,

### **VENDOSI:**

1. Licencimin e operatorit Ujësjetllës Kanalizime sh.a Finiq me:

Drejtues Ligjor    Niko Angjeli  
Drejtues Teknik    Foto Thanasi

2. Operatori Ujësjetllës Kanalizime sh.a Finiq autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategorinë:

Kategoria A, Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;  
Kategoria C, Për largimin e ujërave të ndotura.

3. Zona e shërbimit të këtij operatori janë njësitë administrative të Bashkisë Finiq si më poshtë:
  - a) Finiq (përveç fshatit Vrion)
  - b) Aliko (përveç fshatrave Aliko, Çaush, Neohor, Tremul)
  - c) Dhivër (përveç fshatit Navaricë)
  - d) Mesopotam (përveç fshatrave Livinë, Fitore, Krane, Ardhasovë)
  - e) Livadhja
  
4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4 (katër) vjeçare.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R I

**Ndriçim SHANI**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE  
LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA  
KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR

VENDIM  
Nr.141, datë 27.11.2020

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KOMISIONIT KOMBËTAR RREGULLATOR  
NR. 41, DATË 01.06.2018 “PËR LICENCIMIN E SH. A UJËSJELLËS KANALIZIME  
FINIQ”

Në mbështetje të nenit 13, 14, 16 dhe 17 të ligjit nr. 8102 datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar (**Ligji nr. 8102**), VKM nr. 958, datë 06.05.2009 "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë" (**VKM nr. 958**), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 08.12.2009 "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", e ndryshuar (**Rregullore e licencimit**),

**Komisioni Kombëtar Rregullator,**

në mbledhjen e datës 27.11.2020 pasi shqyrtoi çështjen me objekt: "Mbi miratimin e projekt vendimit "Për një ndryshim në vendimin e Komisionit Kombëtar nr. 41, datë 01.06.2018 "Për licencimin e sh. a Ujës-jellës Kanalizime Finiq"

**Vëren se:**

1. Shoqëria Ujës-jellës Kanalizime Finiq (**UK Finiq**) me shkresën nr. 105 prot. datë 10.11.2020, me lëndë "Dërgim dokumentacioni" ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (**ERRU**) kërkesën për rinovim të licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor të shoqëruar me dokumentacionin sipas përcaktimeve të parashikuara në VKM nr. 958 dhe Rregullores së Licencimit.
2. Komisioni Kombëtar Rregullator (**KKRR**) e gjeti paraqitjen e kërkesës së UK Finiq për rinovim licence për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM nr. 958 dhe Rregulloren e Licencimit.

3. KKRR ka licencuar shoqërinë UK Finiq me vendimin nr. 41, datë 01.06.2018 “Për licencimin e sh. a Ujësjetllës Kanalizime Finiq, me një afat 4 vjeçar, ku shoqëria autorizohet të ofrojë shërbimin e grumbullimit dhe shpërndarjes së ujit për konsum publik, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura.
4. Drejtuesi ligjor i shoqërisë UK Finiq sh.a. z. Mihal Çavo, ka mbaruar studimet e larta në Fakultetin e Inxhinierisë në degën Hidroteknikë.
5. ERRU në vlerësimin e kërkesës për ndryshimin e licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Finiq sh.a të kërkesave të ligjit nr. 8102, të VKM nr. 958 dhe Rregullores së Licencimit, në mënyrë të veçantë sa i takon garantimit që i licencuari të veprojë në përputhje me kushtet e licencës së tij dhe të mbrojë interesat e konsumatorëve në lidhje me cilësinë, eficientë, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit.

Për gjithë sa më sipër Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se aplikimi i UK Finiq është i bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

#### **VENDOSI:**

1. Në pikën 1 të vendimit të KKRR nr. Nr. 41, datë 01.06.2018 “Për licencimin e sh. a Ujësjetllës Kanalizime Finiq” bëhen këto ndryshime:

*“Drejtues Ligjor z. Mihal Çavo”*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.  
Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR**  
**Ndriçim Shani**